



Pranuar / Dërguar Punëtor / Prodato Received / Delivered	20.04.2023	3	vitet and years
Organ / Rrësia Organ / Jednitsa Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Eshlop e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM840K	3729/2023		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.467/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.467/2023 të datës 07.03.2023 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ nga Prishtina, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.04.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.467/2023 e datës 07.03.2023, e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me Nr.Ref: 162/2023 i datës 06.02.2023 i Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

### A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 07.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Ref:162/2023 të datës 06.02.2023 të Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimin së vendimi i kundërshtuar është nxjerrë më shkelje ligjore dhe administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2023 ka proceduar kërkesën përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ( tuje MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 20.03.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku më shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.



*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 07.03.2023 me numër protokolli 2448/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Ref:162/2023 të datës 06.02.2023 të Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emailin e datës 06.02.2023 nga A.M për ankuesen; Vendimin me Nr.Ref:693/2018 i datës 25.07.2018; Akt Emërimit AE.Nr.127/2022 i datës 13.06.2022; Vendimin me Nr. Ref: 244/2021 i datës 25.11.2021; Emailin e datës 14.05.2021 nga Sh.M për E.G; Kërkesën për përgjigje ne ankesë me numër protokolli 2754/2023 e datë 17.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2812/2023 e datës 20.03.2023; Raportin e punës së Komisionit për Grada dhe Disiplinë 16/2028; Procesverbalin dhe Raportin nga Takimi i Komisionit për Grada dhe Disiplinë /01 dhe 02.03.2018 me Nr. Reference 10/2018 i datës 12.03.2018; Shkresë më titull Kërkesat për Grada në vitin 2018 Akt Emërimit e datës 12.05.2014; Vendimin me Nr. Ref: 5452/2014 i datës 03.09.2014.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 12.05.2014. është emëruar në pozitën e punës *Zyrtare për Marrëdhënie Dypalëshe*. Me Vendimin me Nr.Ref:542/2014 të datës 03.09.2014 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme i është miratuar grada diplomatike *Sekretare e Dytë*, ndërsa përmes Vendimit me Nr. Ref: 693/2018 të datës 25.07.2018 ankueses i është miratuar grada diplomatike *Këshilltar*. Pas përfundimit të mandatit katërvjeçar në mision diplomatik, ankuesja në bazë të Akt Emërimit AE.Nr.127/2022 të datës 13.06.2022 ushtron pozitën *Zyrtare e Lartë Ligjore*.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më Vendimin me Nr. Ref: 162/2022 ka shfuqizuar Vendimin me numër referencë 693/2018 të datës 25.07.2018 për dhënin e gradës Diplomatike *Këshilltare* për ankuesen, ndërsa konform rekomandimit të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të datës 12.03.2018 i jepet grada diplomatike *Sekretar i Parë*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë më shkelje ligjore dhe administrative, duke shtuar së dhënia e gradave diplomatike është në kompetencën e Komisionit për Grada dhe Disiplinë ndërsa nuk është në kompetencë dhe as në autoritetin e ministres që të bëjë vlerësimin nëse një gradë është dhënë në bazë të ligjit apo jo.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, i'u referua Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës respektivisht termit grada diplomatike dhe konsullore dhe termit Komisioni për Grada dhe Disiplinë të përcaktuar me nenin 2, i cili përcakton se: *"Gradat Diplomatike dhe Konsullore"- janë titujt e dhënë ose të fituar të përfaqësuesve diplomatikë dhe konsujve, të renditur sipas përparësisë ose epërsisë hierarkike; "Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës"- është komisioni i ngarkuar me dhënie, përveç gradës ambasador, të gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm, si dhe propozimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve të shërbimit të jashtëm dhe shqyrtimin e ankesave për masat disiplinore të marra ndaj tyre".*



Me nenin 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"2. Gradat diplomatike në shërbimin e jashtëm janë: 2.1. ambasador; 2.2. ministër 2.3. ministër këshilltar; 2.4. këshilltar; 2.5. sekretar i parë; 2.6. sekretar i dytë; 2.7. sekretar i tretë; 2.8. atashe. 3. Gradat konsullore në shërbimin e jashtëm janë: 3.1. konsull i përgjithshëm; 3.2. konsull; 3.3. zëvendëskonsull"*,

Me nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"1. Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesore në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës"*.

Me nenin 29 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"1. Periudha minimale për kalimin nga një gradë në një tjetër përcaktohet me Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm. 2. Kriteret për fitimin e gradës ministër këshilltar dhe ministër përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm"*.

Me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"1. Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm; 1.2. shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori i tyre i drejtpërdrejt; 1.3. shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin të Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit që kanë kryer këto shkelje"*.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore ka analizuar edhe dispozitat e nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm i plotësuar sipas nenit 8 të Rregullores QRK- Nr. 04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, më të cilin është përcaktuar se: *"Komisioni ka për detyrë të bëjë Gradimin e Anëtarëve që hyn në Shërbimin e Jashtëm dhe Gradimin e zyrtarëve në kuadër të sistemit për vlerësimin e rezultateve të punës, ashtu siç përcaktohet me këtë Rregullore"*, si dhe nenin 14 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, ku shprehimisht është paraparë se: *"Rezultatet e konfirmimit të Komisionit për dhënien e gradave raportohen të Ministri, i cili duhet të miratojë vendimet përfundimtare të dhëna në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni"*.

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lartë Kolegji konstaton se gradat diplomatike propozohen nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë, ndërsa ministri në pajtim me rekomandimin e Komisionit miraton gradat e propozuara, rrjedhimisht në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Komisioni për Grada dhe Disiplinë mund të propozoj avancimin në gradë për zyrtarin përkatës, e cila metej miratohet nga ministri me vendim përfundimtar.

Bazuar në konstatimin si me lart, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale ka gjetur se me Vendimin Nr.Ref: 542/2014 të datës 03.09.2014 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ankueses i është miratuar grada diplomatike *Sekretare e Dytë*, kurse sipas Procesverbalit me numër reference 10/2018 të datës 10.03.2018 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë është konstatuar se ankuesja kishte bërë kërkesën për avancim në gradë, më ç'rast Komisioni për Grada dhe Disiplinë kishte propozuar që ankuesja të ngritet në një gradë nga grada *Sekretar i Dytë* në gradën *Sekretar i Parë*, mirëpo, Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme përmes Vendimit Nr.Ref:693/2018 të datës 25.07.2018 ka miratuar për ankuesen gradën diplomatike



*Këshilltar.* Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji vlerëson së avancimi në grada duhet të bëhet gradë pas grade dhe se çdo tejkalim i këtij parimi dhe se çdo miratim i gradës apo çdo avancim në gradë pa rekomandim të Komisionit për Grada dhe Disiplinë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren QRK- Nr. 04/2014.

Bazuar në konstatimet si sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson së vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerr në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, i cili përcakton se: "Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj", si dhe nenin 54 të të njëjtit ligj i cili përcakton se: "1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë", kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

*Këshillë juridike:* Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.467/2023

**Avdyll BEKTESHI**

*Avdyll Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**  
*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërrsohet**

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.